

11 shkurt 2019

## Kërkesë për anëtarët e Delegacionit Shtetëror për Dialogun me Serbinë

Të nderuar anëtarë të Delegacionit Shtetëror,

Grupi për Hulumtimin e Politikave të Ballkanit së fundmi ka shqyrtuar çështjen e barazisë gjinore si një nga treguesit e demokracisë në vend. Artikulli të cilin po ju dërgojmë të bashkangjitur pasqyron pozitën tejet të pafavorshme të grave në politikë dhe qeverisjen e vendit.

Krahas hendekut të madh të barazisë në gjitha aspektet e jetës politike dhe përfaqësimit insitucional mes burrave dhe grave, artikulli vë në pah edhe përjashtimin absolut të grave nga delegacioni shtetëror për bisedime me Serbinë.

Praktikat e ndërtimit të paqes së qëndrueshme në vendet e paskonflikteve kanë dëshmuar se përfshirja e grave në këto procese është esenciale. Mungesa e perspektives gjinore në këto procese sjellë në përjashtim të nevojave të dhe drejtave të qytetarëve dhe viktimave gra. Kombet e Bashkuara kanë njohur rëndësinë për përfshirjen e grave në procese të tilla dhe këtë kërkesë e kanë artikulluar përmes Rezolutave [1325](#) dhe [1820](#) të Këshillit të Sigurimit.

Korniza ligjore vendore e ndërkombëtare si dhe syrimi i Kosovës për t'u bërë pjesë anëtare e OKB-së, BE-së dhe organizateve të tjera ndërkombëtare, na obligon të gjithëve, në veçanti Juve si të mandatuar, që të punoni në këtë drejtim dhe të siguroheni në grantimin e sundimit të ligjit dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut.

Si rrjedhojë, Grupi për Hulumtimin e Politikave të Ballkanit ju kërkon që të angazhoheni fuqishëm në përfshirjen e grave në Delegacionin Shtetëror për Dialog duke bërë amandamentimin e Projektiligjit për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror për Dialogun me Serbinë dhe mundësive të tjera që mund të ekzitojnë.

Me nderime,

Ekipi i Grupit për Hulumtimin e Politikave të Ballkanit

